



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.47

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.264, datë 5.5.2006	Për miratimin e fillimit të procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT” të autostradës Tiranë-Elbasan (Vaçar-Papër)..... 1403
Vendim i GJK nr.9, datë 11.5.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.129, datë 2.03.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën..... 1403 ...
Vendim i GJK nr.10, datë 11.5.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.168, datë 27.01.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën..... 1406

VENDIM
Nr.264, datë 5.5.2006

**PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION,
TË FORMËS “BOT” TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN (VAQAR-PAPËR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 2 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime publike dhe infrastrukturë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fillimit të procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT”, të autostradës Tiranë-Elbasan (Vaçar-Papës), sipas propozimit të paraqitur nga shoqëria “Be-Alba-Konstruksion”, sh.p.k., si propozim i papërkuar.

2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të jenë organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për të negociuar dhe nënshkruar marrëveshjen e koncesionit.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

V E N D I M
Nr.9, datë 11.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 09.11.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.46/5 Akti që i përket:

KËRKUES: ARBEN PRIFTI

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.129, datë 02.03.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e këtij vendimi:

1. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur nenin 141 të Kushtetutës, sepse pa pasur juridiksion fillestar ka gjykuar vetë çështjen, duke rënduar pozitën procedurale të të gjykuarit si edhe ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale që parashikon rastet e prishjes së vendimit dhe të zgjidhjes së çështjes pa e kthyer për rigjykim;

- gjykata nuk ka siguruar garancitë e një procesi të rregullt gjyqësor, duke mohuar të drejtën e mbrojtjes, të ankimit efektiv dhe atë të rekursit për çështjet penale;

- vendimi vjen në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për të drejtën e aksesit në gjykatë dhe me parimin e prezumimit të pafajësisë.

2. Është cenuar parimi kushtetues i gjykatës së pavarur dhe të paanshme. Fakti që tre anëtarë të kolegjit kanë marrë pjesë në fazën që lidhet me vleftësimin e masës së arrestit tregon se procesi është paragjykuar. Sipas nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkesin dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.724, datë 17.07.2003, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të kërkuarit Arben Prifti për veprën penale të shpërdorimit të detyrës të kryer në bashkëpunim sipas neneve 248 e 25 të Kodit Penal, si dhe ka urdhëruar lirimin e tij. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.650, datë 18.12.2003.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.129, datë 02.03.2005, ka vendosur prishjen e vendimit nr.650, datë 18.12.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë përse i përket kërkuarit Arben Prifti, deklarinimin e tij fajtor për krimin e shpërdorimit të detyrës dhe, në bazë të neneve 148 e 34 të Kodit Penal, e dënon me 300 mijë lekë gjobë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se nga tërësia e shkaqeve të ngritura dhe shkeljeve të pretenduara nga kërkuari, kontrolli kushtetues duhet të përqendrohet në ato aspekte që kanë të bëjnë me standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, shkaqet e ngritura në kërkesë janë lidhur dhe duhen marrë në funksion të cenimit të procesit të rregullt ligjor në këto dy drejtime kryesore: a) të juridiksionit dhe kompetencës së Gjykatës së Lartë dhe b) të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës.

Për të arritur në një zgjidhje sa më të drejtë të çështjes, këto pretendime duhet të analizohen në lidhje me standardet e gjithëpranuara të procesit të rregullt ligjor të garantuara nga Kushtetuta dhe nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Pretendimi i parë i kërkuarit lidhet me faktin që Gjykata e Lartë, në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale e ka zgjidhur vetë çështjen në themel duke rënduar pozitën e të gjykuarit. Ky pretendim mbështetet me arsyetimin se kërkuari ishte deklaruar i pafajshëm me vendim të gjykatës së shkallës së parë, që është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, dhe Gjykata e Lartë, mbi rekursin e prokurorit, pa asnjë provë të re, por me një arsyetim tjetër të vendimit, e ka deklaruar fajtor dhe dënuar atë. Në këtë mënyrë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale që parashikon rastet e prishjes së vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rigjykim. Kjo dispozitë i jep të drejtë Gjykatës së Lartë ta zgjidhë vetë çështjen pa e kthyer për rigjykim vetëm për shkaqe që janë në favor të pozitës procedurale të të gjykuarit. Këtë kompetencë, Gjykata e Lartë e ka kur vlerëson se ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose të vazhdonte, kur vendimi është dhënë në gabim të personit, ose kur vendimi është i pavlefshëm për shkaqet e parashikuara në ligj. Rëndësi ka fakti se në të gjitha rastet e parashikuara nga kjo dispozitë, Gjykata e Lartë vendos pushimin e gjyqimit ose urdhëron të zbatohet vendimi që ka caktuar dënimin më pak të rëndë, por në asnjë rast nuk mund të deklarojë fajtor e të dënojë të gjykuarin që ka marrë pafajësi në shkallët e tjera të

grykimit, siç ka vepruar me kërkuesin. Duke vendosur të kundërtën e asaj që i lejon ligji, Kolegji Penal i Grykatës së Lartë ka dalë jashtë juridiksionit të tij dhe ka marrë atributet e një grykate fakti, gjë që e bën procesin të parregullt. Ai ka rënduar padrejtësisht pozitën e të grykuarit, pa i dhënë atij mundësinë dhe garancinë ligjore e kushtetuese për të përgatitur e realizuar mbrojtjen për rrethanat e reja të krijuara. Parimi i së drejtës së mbrojtjes është shkelur për faktin se nga Kolegji Penal i Grykatës së Lartë u prishën vendimet për pafajësinë e kërkuesit dhe ai u deklarua fajtor pa u kthyer çështja për rigrykim.

Një qëndrim të tillë kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Grykatës së Lartë në vendimin nr.2, datë 19.04.2001, për unifikimin e praktikës gryqësore duke përcaktuar se në rastet e shkeljes së ligjit nga grykatat më të ulëta në dhënien e vendimeve, Grykata e Lartë ka detyrimin ligjor, t'i prishë këto vendime dhe të disponojë në një nga mënyrat që përcakton neni 441 i Kodit të Procedurës Penale.

Por, në rastin e kërkuesit, Kolegji Penal i Grykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me këtë vendim unifikues, sepse nuk ka disponuar në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale, duke e privuar kërkuesin nga e drejta e mbrojtjes si një e drejtë themelore në grykimin penal, gjë që e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

Në këtë rast, garantimi i së drejtës së mbrojtjes merr rëndësi të veçantë për kërkuesin, pasi ai, nga gjendja e favorshme që ishte krijuar për të si rezultat i marrjes së pafajësisë, u vu papritur në një pozitë të pafavorshme, për të cilën duhej të përgatiste mbrojtjen e tij. Në rastin konkret Kolegji Penal i Grykatës së Lartë për të zbatuar drejt kërkesat e Kushtetutës dhe të ligjit procedural, pas prishjes së vendimeve, duhej ta kthente çështjen për rigrykim për t'i dhënë mundësi kërkuesit të përfitojë të drejtat që garanton neni 31 i Kushtetutës gjatë procesit penal lidhur me kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e vet.

Mohimi i së drejtës së mbrojtjes prek standarde kushtetuese të rëndësishme, për të cilat Grykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim të palëkundur në disa vendime të saj, sepse këto shkelje cenojnë parimin e mbrojtjes në gryq dhe ndikojë drejtpërdrejt dhe negativisht në dhënien e drejtësisë (vendimi nr.33, datë 24.05.2000 i Grykatës Kushtetuese).

Kolegji Penal i Grykatës së Lartë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale, ka dalë jashtë juridiksionit që i njeh ligji, gjë që e bën procesin të parregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Sipas kërkuesit, vendimi i Kolegjit Penal të Grykatës së Lartë është në kundërshtim edhe me standardet e procesit të rregullt që kanë të bëjnë me grykatën e pavarur dhe të paanshme. Këtë ai e mbështet në faktin se tre gryqtarë të këtij kolegji që grykuan çështjen, kanë marrë pjesë më parë në seancën lidhur me vleftësimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin. Në këto rrethana, pretendohet se procesi është paragrykuar, duke shkelur edhe kërkesat e nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit gryqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit nuk mund të marrë pjesë në grykim.

Grykata Kushtetuese vlerëson se këto shkelje të pretenduara lidhen direkt me konceptin e grykatës së paanshme dhe si të tilla i nënshtrohen kontrollit kushtetues për të përcaktuar nëse janë prekur standardet e procesit të rregullt ligjor. Që t'i jepet një përgjigje kësaj pyetjeje, duhet parë konkretisht përbërja e trupit grykues në deklarimin fajtor dhe dënimin e kërkuesit. Për çështjen objekt grykimi, një vlerësim objektiv duhet të bëhet në lidhje me pozitën e veçantë të gryqtarit të Grykatës së Lartë, që ka të bëjë me natyrën e grykimit në këtë grykatë.

Grykata Kushtetuese vlerëson se grykimi i çështjes në Grykatën e Lartë, si në rastin e vleftësimit të masës së arrestit dhe në dhënien e vendimit përfundimtar, ka të bëjë me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të grykatave më të ulëta, të cilat janë marrë duke analizuar në tërësi provat dhe rrethanat e çështjes. Grykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen për të kontrolluar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankmuara. Në këtë kuptim, grykimi i çështjes nga Kolegji Penal i Grykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet i njëanshëm vetëm për faktin se disa anëtarë të tij kanë marrë pjesë më parë në vleftësimin e arrestit për të njëjtën çështje.

Nga kjo analizë arrihet në përfundimin se pjesëmarrja e disa anëtarëve të Grykatës së

Lartë në vleftësimin e masës së arrestit për kërkuesin nuk e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

Përfundimisht, në mbështetje të argumenteve të mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se me zgjidhjen që i ka bërë çështjes Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka dalë jashtë juridiksionit të tij, duke i mohuar kërkuesit të drejtën për t'u mbrojtur, gjë që e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.129, datë 02.03.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr.10, datë 11.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 12.12.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.47/6 Akti që i përket:

KËRKUES: FESTIM HOXHA, përfaqësuar nga avokat Koçi Mato, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. **KËSHILLI I QARKUT ELBASAN**, në mungesë.

2. **KËSHILLI I KOMUNËS QUKËS, LIBRAZHID**, përfaqësuar nga juristja Thëllëza Shebeku, me autorizim.

3. **ISMAIL KRYEZIU**

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.168, datë 27.01.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Shkaqet të cilat, sipas kërkuesit, e bëjnë vendimin të papajtueshëm me Kushtetutën janë:

1. Gjykata e Lartë ka pushuar çështjen me argumentin se mosmarrëveshja, objekt gjykimi, nuk hyn në rrethin e çështjeve që shqyrtohen nga gjykata dhe se çështja hyn në juridiksionin administrativ.

2. Ky qëndrim i Gjykatës bie ndesh me kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës për të drejtën që ka çdo individ për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe me përmbajtjen e neneve 324 e 325 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Në rastin konkret, janë ezauruar mundësitë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në rrugë administrative.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në zgjedhjet lokale të 12 tetorit të vitit 2003, kërkuari është zgjedhur anëtar i Këshillit të Komunës Qukës, Librazhd, si përfaqësues i subjektit politik, Balli Kombëtar.

Në bazë të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", në datë 04.11.2003, bëhet konstituimi i këshillit të komunës, ku u procedua edhe për zgjedhjen e dy anëtarëve për në Këshillin e Qarkut Elbasan. Nga votimi i parë kërkuari arriti të marrë votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i këshillit të qarkut, por drejtuesit e mbledhjes organizuan një votim tjetër, nga i cili doli fitues subjekti i interesuar, Ismail Kryeziu.

Kundër vendimit të këshillit të komunës, kërkuari është ankuar pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, nga i cili ka marrë përgjigje negative. Pas kësaj, ai i drejtohet gjykatës së rrethit duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të këshillit të komunës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.26, datë 14.01.2004, ka vendosur pranimin e padisë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.219, datë 21.04.2004. Mbi rekursin e personit të interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin objekt kërkesë, prish dy vendimet e gjykatave dhe e pushon çështjen me arsyetimin se "mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk hyn në rrethin e çështjeve që shqyrtohen nga gjykata, prandaj çështja hyn në juridiksionin administrativ".

Gjykata Kushtetuese çmon se përfundimi në të cilin ka arritur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke e nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, i mohon individit të drejtën për akses në gjykatë, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, kushdo mund t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Arsyetimi që bën Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendim, se mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk hyn në rrethin e çështjeve që shqyrtohen nga gjykata, bie në kundërshtim me nenet 324 e 325 të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se në kompetencë të seksioneve për gjykimet administrative është "padia me të cilën kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i një akti administrativ" dhe se padia mund të ngrihet "kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cenohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive".

Padia e ngritur nga kërkuari është në përputhje të plotë me kërkesat e këtyre dispozitave dhe si e tillë është pranuar për gjykim dhe është shqyrtuar nga dy shkallët e gjykimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton në vendim se të dyja gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", pasi ai nuk përcakton gjykatën si organ kompetent për zgjidhjen e konflikteve që lindin gjatë kryerjes së procedurave të votimit për mandatet e këshilltarëve.

Gjykata Kushtetuese çmon se mospërmendja shprehimisht, nga dispozitat e ligjit ku referohet Kolegji Civil, e kompetencës së gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla, nuk përlligj nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, përderisa dispozitat e Kodit të Procedurës

Civile, nuk e ndalojnë që çështje të tilla hyjnë në juridiksionin gjyqësor.

Nga ana tjetër, ky Kolegj shprehet se çështja hyn në juridiksionin administrativ, ndërkohë që ligji për qeverisjen vendore nuk ka përcaktuar se cili organ është kompetent për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të tillë dhe as procedurën përkatëse.

E drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t'u drejtuar me padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen, në bazë të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Qëllimi është që ndaj veprimeve të pushtetit administrativ që prekin të drejtat e individit, duhet të ushtrohet një kontroll, i cili nuk mund të jetë tjetër veçse kontroll gjyqësor. "Shteti ligjor presupozon, ndër të tjera, që një ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv që normalisht i përket gjyqësorit, i cili ofron garantimin më të mirë të pavarësisë, paanësisë dhe procesit të rregullt".¹

Në ushtrimin e kontrollit kushtetues për çështje të kësaj natyre, Gjykata Kushtetuese mban parasysh edhe faktin se ligji përcakton edhe rastet kur nuk mund të bëhet ankim në gjykatë ndaj një akti administrativ, por rasti i kërkesës nuk inkadrohet në asnjë nga këto aspekte përjashtimore të ligjit, që t'i jepte të drejtë gjykatës ta nxirrte çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij, nuk përcakton dhe as nuk nënkupton përjashtime të tilla, por shprehet në mënyrë të thjeshtëzuar dhe të pakonkretizuar se kërkesa nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, pasi ai duhej ta mbronte këtë të drejtë në rrugë administrative.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në rrethanat e paraqitura, çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ishte i detyruar të shprehej në lidhje me shkaqet e pretenduara në rekurs, duke bërë të mundur realizimin e një të drejte të ligjshme të kërkesës. Detyrimet kushtetuese e ligjore lidhur me të drejtën e individëve për t'u ankuar në gjykatë, kundër akteve e veprimeve administrative, kanë për qëllim kontrollin e këtyre të fundit në funksion të respektimit të të drejtave e lirive të njeriut dhe realizimit të drejtësisë. Organet administrative, edhe pse shqyrtojnë e zgjidhin mosmarrëveshje sipas kompetencave që u janë dhënë, ato nuk mund të quhen organe që japin drejtësinë, pasi një funksion i tillë u përket vetëm gjykatave.

Juridiksioni gjyqësor në një shtet të së drejtës, nëpërmjet kontrollit të ligjshmërisë së akteve administrative, luan një rol të dukshëm e të rëndësishëm në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është e padrejtë dhe ka prekur standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e mohimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, pra të përjashtimit të vetë procesit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe në nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.168, datë 27.01.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

¹ Çështja Klass, dt.06.09.1978, Setria A. nr.28, fq.25-26.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 12.5.2006
Doli nga shtypi më 16.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë